


ProCredit Bank

ProCredit

*Diversiteti, gjithëpërfshirja,
dhe drejtësia gjinore*

www.procreditbank-kos.com

BULETINI, Q3/2023

Tema për grupin në vitin 2023: Diversiteti, gjithëpërfshirja dhe drejtësia gjinore

Arritja e diversitetit, gjithëpërfshirjes dhe drejtësisë gjinore janë objektiva të rëndësishme për bankën ProCredit, si për të siguruar një mjedis pune të drejtë dhe gjithëpërfshirës, ashtu edhe për të pasqyruar vlerat tona dhe respektin që kemi për njëri tjetrin. Pikërisht për këtë arsye i kemi përzgjedhur si tema kryesore për vitin 2023.

Para se të fillojmë, ja disa përkufizime të dobishme të termave që do të përdorim gjatë diskutimeve tona:

Diversiteti i referohet pranisë së një game të gjerë dallimesh dhe identitetesh individuale brenda një grupi, organizate ose komuniteti. Këto dallime përfshijnë racën, gjininë, moshën, përkatësinë etnike, orientimin seksual, fenë, aftësitë, prejardhjen socio-ekonomike dhe tipare të tjera.

Gjithëpërfshirja pasqyrohet në krijimin e një mjedisi ku të gjithë individët ndihen të vlerësuar, të respektuar dhe të mbështetur, pavarësisht dallimeve të tyre. Gjithëpërfshirja nënkupton pranimin aktiv të perspektivave dhe kontributeve të ndryshme për të krijuar një ndjenjë përkatesie për çdo person.

Drejtësia i referohet konceptit të sigurimit të qasjes në mundësi, burime dhe përparësi të njëjta për të gjithë,

pavarësisht dallimeve të tyre. Synimi është të adresojë pengesat sistematike dhe strukturore që mund ta pengojnë pjesëmarrjen dhe suksesin e plotë të grupeve të caktuara.

Pabarazitë gjinore pasqyrohen në padrejtësitë historike dhe normat shoqërore që kanë formësuar trajtimin e pabarabartë të grupeve të ndryshme. Këto pabarazi shpesh janë shumë të dukshme dhe lehtë të kuptueshme, prandaj shumica e njerëzve kanë njëfarë njohurie rreth tyre si koncept. Trajtimi i pabarazive gjinore është një qëllim që duhet të rezonojë të të gjithë ne dhe përbën pikënisje të përshtatshme për diskutimin e çështjeve më të gjera të diversitetit dhe gjithëpërfshirjes.

“Barazia gjinore nuk është vetëm një e drejtë themelore e njeriut, por edhe një themel i domosdoshëm për një botë paqësore, të begatë dhe të qëndrueshme.”¹

“Ne ende përballemi me një hendek të theksuar gjinor. Në vitin 2022, ky hendek gjinor është ngushtuar në masën 68.1%. Me ritmin aktual të progresit, do të duhen 132 vjet për të arritur barazinë e plotë.”²



Dallimi ndërmjet barazisë gjinore dhe drejtësisë gjinore

Barazia gjinore dhe drejtësia gjinore janë aktualisht temë e shumë diskutimeve, por dallimi mes këtyre dy koncepteve nuk është gjithmonë i qartë menjëherë. Siç e tregon tabela më poshtë, e para është qëllimi, ndërsa e fundit e përgatitë rrugën


Barazia gjinore

K

Drejtësia


- Barazia midis grave, burrave dhe personave me gjini diverse
- Të drejta, përgjegjësi dhe mundësi të barabarta për të gjitha gjinitë

- Procesi i arritjes së barazisë gjinore
- Trajtimi i drejtë për burrat, gratë dhe personat me gjini diverse
- Marrja parasysh e rrethanave personale
- Përcaktimi i veprimeve specifike për të korrigjuar disavantazhet dhe për të barazuar fushën e lojës



Diversiteti, gjithëpërfshirja dhe drejtësia gjinore në ProCredit

Pse është e rëndësishme kjo temë për ne?



Banka ProCredit ka një mjedis pune shumë të larmishëm me baza kulturore, shoqërore dhe fetare të ndryshme. Ne duam të garantojmë një mjedis të hapur, të paanshëm, gjithëpërfshirës dhe të drejtë për të gjithë. Për ta arritur këtë, duhet të sigurohemi rregullisht që të gjithë të kemi të njëjtin qëndrim etik, pavarësisht dallimeve në arsimim,

Integriteti personal

- Nderi dhe integriteti
- Trajtimi i drejtë dhe i barabartë pavarësisht dallimeve
- Pa diskriminim ose ngacmim
- Promovimi i diversitetit

formim ose norma shoqërore. Ofrimi i mundësive të barabarta dhe i trajnimeve të barabarta, si dhe rekrutimi dhe promovimi i personave më të mirë – pavarësisht gjinisë së tyre – siguron që çdo punonjës të ketë të njëjtat mundësi karriere. Ky parim vlen edhe për qasjen tonë ndaj klientëve dhe shoqërisë në përgjithësi.³

ProCredit në shifra: Drejtësia gjinore në grup në vitin 2022



Nuk ka dallim në paga për shkak të gjinisë kur krahasohen pozitat dhe përvoja

Numri i përgjithshëm i punonjësve në 2022



Femra 61%

Meshkuj 39%

Mesatarja e viteve të punës është 12.5 si për burrat, ashtu edhe për gratë

Menaxhmenti i mesëm



Femra 48%

Meshkuj 52%

Nga 136 personat që kanë përfunduar Akademinë e Menaxhimit ProCredit (në pesë vitet e fundit), 46% janë gra dhe 54% janë burra

Bordi Menaxhues



Femra 38%

Meshkuj 62%



Bordi Mbikëqyrës:



Femra 47% / Meshkuj 53%

Kohëzgjatja mesatare e trajnimit për punonjës:

121 orë për gratë

136 orë për burrat

Edhe pse kemi një pozicion të mirë falë investimit të fuqishëm në të gjithë stafin tonë, pa dallim gjinor ose karakteristikash të tjera, ende kemi rrugë për të bërë.⁴

Kemi punuar ngushtë me Akademinë dhe departamentet e Burimeve Njerëzore të bankave për të vendosur një bazë të fortë në qasjen ndaj diversitetit, gjithëpërfshirjes dhe drejtësisë gjinore. Ne filluam nga supozimi se ekziston interesi i brendshëm i të gjithë kolegëve për këto tema dhe se duhej krijuar një mirëkuptim i përbashkët për problemet

që duhen adresuar. Në këtë drejtim, kemi zhvilluar këto aktivitete:

- Kurs i ri për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen, i prezantuar në Akademinë e Menaxhimit në shtator të këtij viti
- Punëtorja e Kodit të Sjelljes 2023 për drejtësinë gjinore, ku kanë marrë pjesë të gjithë kolegët

4 Më shumë informacion rreth qasjes së grupit ndaj stafit mund të gjendet në Politikën tonë të BNJ-ve, veçanërisht në seksionet 2.1 Sfida e identitetit, 2.2 Sfida e rekrutimit dhe 2.4 Sfida e strukturës së drejtë dhe të komunikueshme të pagesave.

Trajnimi për Kodin e Sjelljes 2023

Trajnimi i këtij viti për Kodin e Sjelljes përfshin një diskutim në grup, në mënyrë që të prekim paragjykimet dhe stereotipat shoqërore e personale që lidhen me gjininë. Qëllimi i trajnimit është:

- Rritja e vetëdijes për pabarazinë gjinore dhe që të sigurohemi që të gjithë të kenë të njëjtin informacion
- Të kuptojmë se sa të hapur dhe pa paragjykime jemi në të vërtetë: Me çfarë “syzesh” e shohim botën?
- Të diskutojmë se si secili nga ne mund të kontribuojë në zvogëlimin e pabarazive ekzistuese gjinore dhe në sigurimin e mundësive të barabarta

Citate nga pjesëmarrësit e trajnimit:

“Në trajnimin e Kodit të Sjelljes mësova se sa i rëndësishëm është diversiteti dhe gjithëpërfshirja”. “Në jetën e përditshme, shpesh nuk jemi të vetëdijshëm për stereotipat gjinorë që rrënjosen me kalimin e kohës”. “Në trajnimin tonë patëm mundësi të vëmë në pikëpyetje shumë gjëra dhe të ndajmë përvojat nga vendet tona”.

“Në diskutim, jo vetëm që mësojmë, por edhe vendosim standarde të reja. Mund të rritesh personalisht përmes sfidave të reja dhe njëkohësisht të ndihmosh në formësimin e kompanisë.”

“Si një punonjës i ri, mësova që orientimi ndaj ndikimit nuk përcaktohet vetëm në qëllime, por është i ngulitur tashmë në mënyrën se si punojmë”.



Përmes diskutimeve intensive dhe me animacione gjatë trajnimit, pjesëmarrësit arritën në përfundimet e mëposhtme:

- Paragjykimet, mikroagresionet dhe stereotipat janë ende shumë të pranishme; nganjëherë shfaqen haptas, por shpesh pa dashje
- Këto paragjykime burojnë nga mjedisi ynë edukativ dhe kulturor
- Nëse duam ta trajtojmë problemin në mënyrë strukturore, duhet ta diskutojmë haptas, në mënyrë që të jemi më të vetëdijshëm dhe të reflektojmë mbi bindjet dhe pikëpamjet tona
- Duhet të kujtojmë gjithnjë se të gjithë jemi subjekt i paragjyqimeve, prandaj është në interesin e të gjithëve t'i identifikojmë dhe t'i luftojmë ato



Drejtësia gjinore në ProCredit në Ekuador



Një shembull i mirë i përkushtimit tonë ndaj drejtësisë gjinore është puna që po bëhet nga banka ProCredit në Ekuador. Kolegët tanë atje kanë marrë tashmë disa masa gjatë tri viteve të fundit për të promovuar drejtësinë gjinore:

- Organizimi i sesioneve ndërgjegjësuëse dhe i punëtorive për stafin e bankës dhe familjet e tyre, për klientët dhe për komunitetin
- Krijimi i grupeve të brendshme punuese
- Pjesëmarrja në ngjarje të jashtme të lidhura me drejtësinë gjinore
- Angazhimi i klientëve në këtë temë, sidomos përmes një programi për fuqizimin e sipërmarrëseve gra
- Fillimi i procesit për ta certifikuar bankën si një kompani pa dhunë

Për më shumë detaje, ju lutem kontaktoni kolegen tonë nga Ekuadori: Johanna Granitzer (Johanna.granitzer@procredit-group.com)

Procesi i krijuar për parandalimin e dhunës dhe ofrimin e mbështetjes:



Perspektiva: Hapat e radhës në nivel grupi

Duke ndjekur shembullin e suksesshëm të Ekuadorit, ne do të prezantojmë aktivitete të ndryshme në nivel grupi, si:

- Ofrimi i trajnimeve për ndërgjegjësimin mbi drejtësinë gjinore në të gjithë grupin: Të gjithë punonjësit po marrin pjesë në diskutimet e Kodit të Sjelljes këtë vit
- Pjesëmarrja në aktivitete të jashtme dhe angazhimi i klientëve rreth temës së drejtësisë gjinore
- Anëtarësimi në 2X Global¹ (i parashikuar për në fund të shtatorit 2023)
- Përballja me sfidën gjuhësore për të gjetur terminologji gjithëpërfshirëse gjinore
Zbatimi i Planit të Veprimit Gjinor, duke filluar me seanca trajnimi, matjen e pjesëmarrjes së grave në strukturat e pronësisë dhe të vendimmarrjes së NMVM-ve që i financojmë, kryerja e hulumtimeve në treg dhe hartimi i një Strategjie të mirëfilltë Gjinore për grupin



¹ 2X Global është një organizatë globale për investitorët, ofruesit e kapitalit dhe ndërmjetësit që veprojnë në tregjet publike dhe private, si në ekonomitë e zhvilluara ashtu edhe në ato në zhvillim, e përkushtuar ndaj investimeve me perspektivë gjinore.